



PLATFORMA CIVIKOS

PASQYRAT FINANCIARE ME RAPORT TË AUDITORËVE TË PAVARUR
Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024

PËRMBAJTJA

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR.....	3
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	6
PASQYRA E BILANCIT TË FONDEVE	7
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	8
1. Informata të Organizatës	9
2. Baza e përgatitjes.....	10
3. Përmbledhja e politikës së rëndësishme në kontabilitet	10
4. Paraja dhe ekuivalentët e saj.....	11
5. Llogaria e arkëtueshme.....	11
6. Të hyrat e shtyra	11
7. Llogaria e pagueshme.....	11
8. Të hyrat.....	12
9. Shpenzimet e pagave të administratës.....	12
10. Shpenzime programore.....	12
11. Shpenzimet administrative	13
12. Ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese	13



NOVAZA L.L.C.
Str. Fehmi Agani 42/1
10000 Prishtinë, Kosovë

t: +383 (0)44-993-337
w: www.novaza-ks.com
e: info@novaza-ks.com

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për: Menaxhmentin e Platforma CIVIKOS

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Platforma CIVIKOS (Organizata), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2024 dhe pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Organizatës për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2024 janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kërkesat për raportim financiar të përshkruar në shënimin 2 dhe kërkesave sipas ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga organizata në pajtueshmëri me kërkesat etike që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike në pajtueshmëri me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e përfuara të auditimit janë të majftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në pajtueshmëri me dispozitat e raportimit financiar të organizatës dhe ligjeve relevante në Kosovë dhe për kontrole të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës të vijoje sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likuideojë ose të ndërpresë aktivitetet e organizatës, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të organizatës.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojmë evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimi, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e organizatës për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përftuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që organizata të mos vijojë aktivitetet e saj.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënës të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënës në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Altin Sahiti
Auditor ligjor



Prishtinë, Kosovë
10 mars 2025

PLATFORMA CIVIKOS

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR


Me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat në Euro)

<u>Për vitin që përfundon më 31 dhjetor</u>		<u>2024</u>	<u>2023</u>
	Shënimet		
Asetet			
Asetet qarkulluese			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	66,024	60,615
Llogaritë e arkëtueshme	5	2,627	
Gjithsej asetet qarkulluese		68,651	60,615
Asetet jo-qarkulluese			
Prona, impiantet dhe paisjet		-	-
Total asetet jo-qarkulluese		-	-
<u>GJITHSEJ ASETET</u>		<u>68,651</u>	<u>60,615</u>
DETYRIMET DHE FONDET			
Detyrimet rrjedhëse			
Të hyrat e shtyera	6	68,551	60,615
Llogaritë e pagueshme	7	100	
Gjithsej detyrimet rrjedhëse		68,651	60,615
Fondet			
Saldoja e bartur		-	-
Teprica / (mungesa) për vitin		-	-
Gjithsej fondet		-	-
<u>GJITHSEJ DETYRIMET DHE FONDET</u>		<u>68,651</u>	<u>60,615</u>

Aprovuar nga:

Donika Emini – Drejtore Ekzekutive




Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 12 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.

PLATFORMA CIVIKOS

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat në Euro)

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor		2024	2023
	<i>Shënimet</i>		
Të hyrat			
Të hyrat nga Grantet	8	189,070	161,043
Gjithsej të hyrat		189,070	161,043
Shpenzimet			
Shpenzimet e pagave administrative	9	(87,397)	(107,865)
Shpenzimet programore	10	(74,238)	(34,053)
Shpenzimet administrative	11	(27,435)	(19,125)
Gjithsej shpenzimet		(189,070)	(161,043)
Suficiti/(Deficiti) i vitit		-	-

Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 12 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.

PLATFORMA CIVIKOS

PASQYRA E BILANCIT TË FONDEVE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat në Euro)

	Suficiti / (Deficiti) e akumuluar	Gjithsej
Më 1 Janar 2023		
Suficiti / (deficiti) për vitin	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	-	-
Më 1 Janar 2024		
Suficiti / (deficiti) për vitin	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	-	-

PLATFORMA CIVIKOS

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat në Euro)

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor		2024	2023
	Shënimet		
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			-
Fitimi / (humbja) i/e vitit			-
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave		-	-
Zhvierësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		-	-
Fitimi para ndryshimit në asete dhe obligime			
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative (Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	(2,627)	-
Rritja / (zvogëlim) në llogaritë e pagueshme	7	100	-
Rritja / (zvogëlim) në të hyrat e shtyera	6	7,936	(15,454)
Rrjedha e parasë e gjeneruar nga veprimtaria		5,409	(15,454)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		5,409	(15,454)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			-
Blerje e tokës, ndërtesës, makinerive dhe pajisjeve		-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		-	-
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë		5,409	(15,454)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	4	60,615	76,069
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	4	66,024	60,615

Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 12 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.

PLATFORMA CIVIKOS

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat në Euro)

1. Informata të Organizatës

Platforma CIVIKOS ("CIVIKOS") është një iniciativë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë që ka filluar në fillim të vitit 2007 dhe është regjistruar zyrtarisht më 2 Shtator 2007 me numër fiskal: 600436506 dhe numër të OJQ: 5111660-7. Qëllimi i saj është krijimi dhe promovimi i një mjedisi të përshtatshëm për bashkëpunimin midis sektorit formal të shoqërisë civile dhe institucioneve publike të Kosovës. E mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur dhe me pjesëmarrjen e shumë anëtarëve të organizatave të shoqërisë civile dhe zyrtarëve të qeverisë, kjo iniciativë u lansua zyrtarisht në Korrik 2007. Pas një procesi të gjatë konsultimi me mbi 130 organizata, më 9 Nëntor 2007 u nënshkrua një Memorandum Bashkëpunimi midis Qeverisë së Kosovës dhe shoqërisë civile (përfaqësuar nga Platforma CIVIKOS). Ky memorandum është dokumenti i parë zyrtar që garanton një angazhim të ndërsjellë dhe bashkëpunim institucional midis qeverisë dhe shoqërisë civile.

Platforma CiviKos shërben si një urë lidhëse në mes të qeverisë dhe shoqërisë civile pasi është organi kryesor pranues për draft rregullat, rregulloret dhe ligjet, të cilat më pas i shpërndahen organizatës anëtare për konsultim publik. CiviKos është regjistruar si shoqatë.

Në rritje të vazhdueshme dhe aktualisht me 301 organizata anëtare të shoqërisë civile, Platforma CiviKos është e përkushtuar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet organizatave anëtare, si dhe autoriteteve publike dhe palëve të tjera të interesuara në zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë. Prandaj, CiviKos është i pozicionuar mirë për të promovuar parimet e partneritetit dhe për të ushtruar presionin e nevojshëm mbi qeverinë dhe institucionet e tjera publike në zbatimin e parimeve të koordinimit, bashkëpunimit dhe partneritetit.

Pesë donatorët kryesorë të CiviKos janë USAID-i në Kosovë, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Qeveria Suedeze, Ambasada Holandeze në Kosovë dhe Ambasadat Zvicerane dhe Daneze. CiviKos është një partner kyç në vendosjen e standardeve për konsultime publike dhe zbatimin e Strategjive të Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile (më e fundit: 2019-2023). Në vitin 2018, CiviKos realizoi me sukses një projekt të mbështetur nga Ambasada e Holandës në Kosovë, duke u fokusuar veçanërisht në forcimin e organizatave të shoqërisë civile për të marrë pjesë në mënyrë efektive në proceset vendimmarrëse. Në vitin 2019, përmes mbështetjes së Ambasadës Zvicerane dhe Daneze, Platforma CiviKos realizoi një projekt që posaçërisht promovon dialogun ndërmjet shoqërisë civile dhe qeverisë në nivel qendror dhe lokal. Për më tepër, CiviKos ka zbatuar edhe projekte të financuara nga USAID për të mbështetur OSHC-të bazë në monitorimin e prokurimit publik në nivel lokal dhe ekspozimin e korrupsionit, ndërsa projekti i financuar nga Qeveria Suedeze ka mbështetur organizatat e nivelit lokal në promovimin e të drejtave të njeriut dhe krijimin e strategjive avokuese. CiviKos në vitin 2022 ka zbatuar projektin njëvjeçar të financuar nga Balkan Trust Fund for Democracy dhe financuar nga USAID për të mbështetur Këshillin për bashkëpunim ndërmjet shoqërisë civile dhe qeverisë për të përmirësuar legjislacionin për kontraktimin e shërbimeve për OSHC-të në Kosovë.

Kështu, bashkëpunimi ndërmjet shoqërisë civile dhe autoriteteve publike, ngritja e ndërgjegjësimit dhe përmirësimi i respektimit të të drejtave të njeriut, zbatimi i konsultimeve publike dhe parimet e aksesit në dokumentet publike, si dhe krijimi i mjeteve, platformave dhe dialogëve për të lehtësuar përmirësimet në publik në fushat në lidhje me janë të gjitha ekspertiza e CiviKos-it, të cilën e vendos edhe ky projekt.

PLATFORMA CIVIKOS

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat në Euro)

2. Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 06/L-043 Për Lirinë e Asocimit në Organizatat Jo-qeveritare me qëllim të raportimit në Zyrën e Rregullatorit të OJQ-ve.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në baze të kontabilitetit në baze akruale për të hyrat dhe shpenzimet.

Të hyrat nga grantet njihen kur fitohen në vend se kur pranohen dhe shpenzimet njihen kur ndodhin në vend se kur paguhen.

Përveç kësaj, detyrimi i shtyrë i grantit, parapagimet dhe detyrimet e tjera regjistrohen sipas bazës akruale të kontabilitetit. Politikat e rëndësishme të kontabilitetit janë përshkruar më poshtë.

3. Përmbledhja e politikës së rëndësishme në kontabilitet

3.1. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paranë në arkë dhe paranë e pakushtëzuar me bankat ose depozitat me afat maturimi më pak se tre muaj.

3.2. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose për t'u arkëtuar dhe përfaqëson vetëm shumën e arkëtueshme nga donatorët në lidhje me listën e pagave, shpenzimet operative dhe shpenzimet tjera të shkaktuara.

3.3. Transaksionet në valuta të huaja

Transaksionet në valuta të ndryshme nga valuta funksionale (valutë të huaj) regjistrohen në normat e këmbimit që mbizotërojnë në datat e transaksioneve. Në çdo datë raportimi, zërat monetare të shprehur në valutë të huaj konvertohen në normat mbizotëruese në datën e raportimit. Zërat jo-monetarë që maten me kosto historike në valutë të huaj nuk ripërkthehen. Diferencat e këmbimit që rrjedhin nga zërat monetare, janë të përfshira në fitimin dhe humbjen e periudhës në të cilën ato lindin.

3.4. Përfitimet e punonjësve

Organizata nuk ka përgjegjësi shtesë për pensionet e punëtorëve përveç pagesës së kontributeve pensionale në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

3.5. Kontigjencat dhe provizionet

Detyrimet kontigjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen përveç nëse mundësia e rrjedhës së mjeteve që trupëzojnë përfitime ekonomike është e largët. Një pasuri kontigjente nuk njihet në pasqyrat financiare por shpaloset kur hyrja e përfitimeve ekonomike është e mundshme. Një provizion është i njohur atëherë kur Organizata ka një detyrim të pranishëm (ligjor ose strukturor) si rezultat i një ngjarje të kaluar dhe është e mundshme që një rrjedhje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkojnë për të shlyer detyrimin, dhe një vlerësim i besueshëm mund t'i bëhet shumës së detyrimit.

3.6. Gjykime kritike kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim

Në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Organizatës, të cilat janë të përshkruara më sipër, menaxhmenti nuk ka herë asnjë gjykim i cili ka efekte të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare

PLATFORMA CIVIKOS

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat në Euro)

4. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Civikos ka të hapur llogari në bankat komerciale që operojnë në Kosovë, përkatësisht në ProCredit Bank. Gjendja e parasë dhe ekuivalentëve të saj me 31 dhjetor 2024 dhe 2023 është:

Më 31 dhjetor	2024	2023
Paraja në arkë	295	162
Paraja në bankë	65,729	60,453
Gjithsej	66,024	60,615

5. Llogaria e arkëtueshme

Llogaria e arkëtueshme paraqet zotimet nga donatorët që deri me 31 dhjetor nuk janë paguar nga ata. Gjendja e llogarisë së arkëtueshme për vitet respektive është si në vijim:

Më 31 dhjetor	2024	2023
Smart Balkans	2,627	-
Gjithsej	2,627	-

6. Të hyrat e shtyra

Të hyrat e shtyra janë të hyra që janë pranuar nga organizata por që barten për vitin pasardhës për shpenzim. Platforma Civikos i ka trajtuar sipas "Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 20 Kontabiliteti i Granteve Qeveritare dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Ndhimën Qeveritare"

Më 31 dhjetor	2024	2023
Fondi Civikos	20,555	26,804
KCSF - CEA 21265002	20,424	15,655
NED 2023-0686	13,045	8,303
DEMOS	-	4,839
Smart Balkan	-	3,013
Anëtarësia	1,461	1,386
CDF 043 RFA-002/01	-	615
Matra	13,066	
Gjithsej	68,551	60,615

7. Llogaria e pagueshme

Llogaria e pagueshme paraqet blerjet që deri me 31 dhjetor nuk janë paguar. Gjendja e tyre për vitet respektive është si në vijim:

Më 31 dhjetor	2024	2023
Llogaritë e pagueshme	100	-
Gjithsej	100	-

PLATFORMA CIVIKOS**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat në Euro)

8. Të hyrat

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2024	2023
Të bartura nga të hyrat e shtyra nga viti paraprak	60,615	76,069
<i>Të hyrat e vitit:</i>		
KCSF - CEA 21265002	50,661	57,850
NED 2022-1123	-	29,115
NED 2023-0686	36,424	14,158
Smart Balkan	13,012	13,949
GIZ 81281114	-	11,077
DEMOS	-	9,400
CDF 043 RFA-002/01	35,000	5,000
CDF/HIV/TB/022/2024	8,000	-
Matra	49,285	-
UN LVG2023036	-	4,950
Fondi Civikos	4,548	-
Anëtarësia	75	90
SlovakAID	-	-
Total të hyrat e vitit në bank	197,006	145,589
Të hyrat e shtyra	(68,551)	(60,615)
Gjithsej	189,070	161,043

9. Shpenzimet e pagave të administratës

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2024	2023
Paga Bruto - administrative	83,465	107,865
Shpenzimet e pagave - projektet	3,932	-
Gjithsej	87,397	107,865

10. Shpenzime programore

Shpenzimet programore janë shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e aktiviteteve dhe projekteve që organizata ka planifikuar të realizojë. Këto shpenzime përfshijnë çdo kosto që është e nevojshme për të mbështetur implementimin e programit ose projektit.

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2024	2023
Përkthimi	315	3,418
Shpenzimet e programit	73,923	30,635
Gjithsej	74,238	34,053

PLATFORMA CIVIKOS

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat në Euro)

11. Shpenzimet administrative

Shpenzimet administrative janë shpenzimet që lidhen me menaxhimin dhe operimin e përditshëm të organizatës, por që shumica nga këto shpenzime nuk janë drejtpërdrejt të lidhura me realizimin e aktiviteteve të programit ose projekteve. Këto shpenzime mbështesin funksionimin e organizatës, dhe janë të nevojshme për të siguruar që OJQ-ja të operojë si një entitet efikas dhe i qëndrueshëm.

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2024	2023
Qeraja, Shërbimet komunale	7,536	8,840
Shpenzimet e zyrës	4,534	6,604
Shpenzimet e veturës	2,855	1,741
Komunikimi (Interneti, Telefoni)	894	878
Tjera	1,665	705
Shpenzimet bankare	266	357
Shpenzimet administrative	9,685	-
Gjithsej	27,435	19,125

12. Ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese

Nuk ka ngjarje që pasojnë datën e raportimit që kërkojnë dhënien e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare të Organizatës.